

11. Сместување во јавни установи за згрижување**Член 37**

Родителите, односно брачните другари на загинали, односно починати учесници во операциите имаат предност при сместување во јавни установи за згрижување без плаќање на партиципација.

Средствата од ставот 1 на овој член ги обезбедува државниот орган во кој учесникот во операциите бил вработен.

V. ПРЕОДНИ И ЗАВРШНИ ОДРЕДБИ**Член 38**

Одредбите на овој закон се однесуваат и на семејствата на учесниците во операциите, загинали пред денот на влегувањето во сила на овој закон.

Член 39

Подзаконскиот акт од членот 30 на овој закон Владата на Република Македонија ќе се донесе во рок од 90 дена од денот на влегувањето во сила на овој закон.

Член 40

Овој закон влегува во сила осмиот ден од денот на објавувањето во „Службен весник на Република Македонија“.

L I G J**PËR TË DREJTAT E POSAÇME TË PJESËMARRËSVE NË OPERACIONET PAQËSORE DHE NË OPERACIONET PËR MBROJTJE KOLEKTIVE JASHTË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË DHE TË ANËTARËVE TË FAMILJEVE TË TYRE****1. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME****Neni 1**

Me këtë ligj rregullohen të drejtat e posaçme të personave ushtarakë dhe civilë me shërbim në Armatën e Republikës së Maqedonisë, të punësuarit në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme, pjesëmarrës në operacionet paqësore dhe në operacionet për mbrojtje kolektive jashtë territorit të Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejshëm: pjesëmarrës në operacione) dhe të anëtarëve të familjeve të tyre, si dhe kushtet dhe procedura për realizimin e tyre.

Neni 2

Si kohë e kaluar në operacionet, në kuptim të nenit 1 të këtij ligji, llogaritet koha nga momenti i nisjes deri në momentin e kthimit në Republikën e Maqedonisë, në lokacionin e paraparë për nisje, përkatësisht kthim.

Neni 3

Statusi i kohës së kaluar si pjesëmarrës në operacionet vërtetohet me certifikatë, të lëshuar nga organi shtetëror në të cilin pjesëmarrësi është i punësuar.

Neni 4

Pjesëmarrës të rënë në operacionet në kuptim të këtij ligji konsiderohen pjesëmarrësit te të cilët ka ndodhur vdekja nga momenti i nisjes deri në momentin e kthimit në Republikën e Maqedonisë.

Neni 5

Pjesëmarrës të vdekur në operacionet në kuptim të këtij ligji konsiderohen pjesëmarrësit, te të cilët në afat prej dy vjetësh nga dita e kthimit në Republikën e Maqedonisë, ka vdekur si pasojë e drejtpërdrejtë nga plaga ose lëndimi, paraqitja e sëmundjes dhe përkeqësimi i sëmundjes, si rezultat i pjesëmarrjes në operacione.

Neni 6

Invalidë të luftës në kuptim të këtij ligji, konsiderohen pjesëmarrësit në operacione, shtënë të cilat janë plagosur, lënduar ose sëmurë, me ç'rast është shkaktuar dëmtim i organizmit, së paku 20%.

Invalidë të luftës në kuptim të këtij ligji, konsiderohen edhe pjesëmarrësit në operacione, organizmi i të cilëve është dëmtuar së paku 20% për shkak të sëmundjes, përkatësisht përkeqësimi i sëmundjes së shkaktuar si pasojë e pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë në veprime të armatosura në operacionet.

Shkallën e dëmtimit nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, që është shkaktuar te pjesëmarrësi në operacione, e verifikon komisioni i mjekëve për verifikimin e invaliditetit ushtarak.

II. TË DREJTAT E PJESËMARRËSVE**Neni 7**

Koha e kaluar gjatë pjesëmarrjes në operacione, llogaritet si kohë e kaluar në shërbim në Armatën e Republikës së Maqedonisë, marrëdhënie pune në Ministrinë e Mbrojtjes, përkatësisht marrëdhënie pune në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Neni 8

Gjatë kohës së pjesëmarrjes në operacione, pjesëmarrësit kanë të drejtën për ndihmë juridike dhe mbrojtje diplomatike-konsullore nga ana e përfaqësive diplomatike-konsullore të Republikës së Maqedonisë në vendin ku janë dërguar dhe nga organet kompetente në Republikën e Maqedonisë.

Neni 9

Gjatë kohës së pjesëmarrjes në operacione, pjesëmarrësit kanë të drejtë për rrogë dhe kompensime të tjera në pajtim me ligjin.

Neni 10

Pjesëmarrësit në operacione, detyrimisht sigurohen në rast të:

- vdekjes, në lartësi prej 150 rrogash mesatare të realizuara në Republikën e Maqedonisë, në muajin kur ka ndodhur vdekja, dhe

- invaliditet të përhershëm, në lartësi prej 200 rrogash mesatare të realizuara në Republikën e Maqedonisë, në muajin kur paraqitura ndodhur invaliditeti.

Mjetet nga paragrafi 1 i këtij neni, i siguron organi shtetëror në të cilin është i punësuar pjesëmarrësi në operacionet.

Neni 11

Koha e kaluar gjatë pjesëmarrjes në operacionet, pjesëmarrësve iu llogaritet në stazhin e sigurimit me kohëzgjatje të shtuar, përkatësisht çdo 12 muaj llogariten në stazhin e sigurimit si 18 muaj.

III. TË DREJTAT E VEÇANTA TË PJESËMARRËSVE NË RAST TË INVALIDITETIT**Neni 12**

Invalidët e luftës nga neni 6 i këtij ligji, përjetësisht janë të liruar nga pjesëmarrja me mjete personale gjatë shfrytëzimit të shërbimeve shëndetësore në mbrojtjen primare, specialistike-konsultative dhe mbrojtjen shëndetësore spitalore në entet shëndetësore në Republikën e Maqedonisë, dhe kanë të drejtë për kompensim të shpenzimeve të rrugës nëse janë dërguar që të shfrytëzojnë shërbime shëndetësore jashtë vendbanimit.

Mjetet për pagesën e kompensimit nga paragrafi 1 i këtij neni, i siguron organi shtetëror në të cilin pjesëmarrësi në operacionet është i punësuar.

Neni 13

Invalidët e luftës nga neni 6 i këtij ligji me invaliditet prej 50% deri në 100% nga grupi I dhe VII, të cilët në territorin e Republikës së Maqedonisë nuk kanë në pronësi banesë ose shtëpi, e as që shfrytëzojnë banesë me qiramarrje në pronësi të Republikës së Maqedonisë kanë të drejtë të marrin banesë me qira, nga banesat në pronësi të Republikës së Maqedonisë.

Kërkesa për realizimin e së drejtës nga paragrafi 1 i këtij neni, i dorëzohet Komisionit për zgjidhjen e çështjes banesore pranë Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

Qiramarrja nga paragrafi 1 i këtij neni është në barrë të organit shtetëror në të cilin pjesëmarrësit në operacionet kanë qenë të punësuar.

Neni 14

Invalidët e luftës nga neni 6 i këtij ligji kanë të drejtë të rehabilitimit profesional, në pajtim me dispozitat të Ligjit për sigurimin pensional dhe invalidor.

Invalidët e luftës nga neni 6 i këtij ligji, kanë të drejtë të rehabilitimit, në pajtim me dispozitat për sigurim shëndetësor dhe mbrojtje shëndetësore.

Mjetet për pagesën e kompensimit në bazë të shfrytëzimit të së drejtës nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, i siguron organi shtetëror në të cilin pjesëmarrësit në aktivitete, përkatësisht operacione, janë të punësuar.

Neni 15

Invalidët e luftës nga neni 6 të këtij ligji kanë të drejtë të blerjes së automjetit deri më 1 500 ccm³ në pronësi personale për përdorim familjar.

Detyrimet doganore dhe tatimin mbi vlerën e shtuar për automjetin të cilat i paguan personi nga paragrafi 1 të këtij neni, i kompenson organi shtetëror në të cilin ka qenë i punësuar personi.

Nëse personi nga paragrafi 1 i këtij neni e shet ose e dhuron automjetin para skadimit të shtatë vjetëve nga dita e blerjes, është i detyruar t'ia kthejë shumën e detyrimeve doganore dhe tatimin mbi vlerën e shtuar për automjetin nga paragrafi 2 i këtij neni organit i cili i ka paguar të njëjtat.

Me përjashtim, nëse automjeti është shkatërruar, dhe nuk për përdorim, i njëjti mund të tjetërsohet, përkatësisht të dhurohet pa obligim për kthimin e detyrimeve doganore dhe tatimit mbi vlerën e shtuar edhe para skadimit të afatit nga paragrafi 3 i këtij neni.

Neni 16

Invalidët e luftës nga neni 6 i këtij ligji, në procedurat para organeve kompetente për realizimin e të drejtave të garantuara me këtë ligj, lirohen nga pagesa e taksave administrative dhe gjyqësore.

Shpenzimet për taksat administrative dhe gjyqësore, bien në ngarkesë të organit shtetëror në të cilin janë të punësuar pjesëmarrësit në aktivitete, përkatësisht operacione.

IV. TË DREJTAT E FAMILJEVE TË PJESËMARRËSVE TË RËNË DHE TË VDEKUR

Neni 17

Familjeve të pjesëmarrësve të rënë dhe të vdekur në operacione, iu përcaktohen të drejtat si vijon:

1. varrimi dhe shpenzimet e varrimit;
2. kompensimi për sigurimin e detyrueshëm;
3. kompensimi i njëhershëm në para;
4. punësimi i një anëtari të familjes;
5. pensioni familjar;
6. përkujdesja banesore;
7. të drejta nga sfera e arsimit;
8. lehtësimet doganore dhe tatimore;
9. lirimi nga pagesa e taksave administrative dhe gjyqësore;

10. lirimi nga pjesëmarrja me mjete personale gjatë shfrytëzimit të shërbimeve shëndetësore, dhe

11. vendosja në entet për përkujdesje.

Familje e pjesëmarrësit të rënë konsiderohen: prindërit, bashkëshortja dhe fëmijët të lindur në martesë ose jashtë martese, fëmijët e birësuar dhe fëmijët të marrë nën përkujdesje (në tekstin e mëtejme: fëmijë).

1. Varrimi dhe shpenzimet e varrimit

Neni 18

Familjet e të rënëve, përkatësisht pjesëmarrësit e vdekur, kanë të drejtë për varrimin e pjesëmarrësve me ose pa nderime shtetërore, në vend ose në lokalitet sipas dëshirës së familjes dhe kompensim për shpenzimet e varrimit.

Kompensim për shpenzimet e varrimit nga paragrafi 1 i këtij neni konsiderohen shpenzimet e bëra për:

- bartjen e të rënit, përkatësisht pjesëmarrësin e vdekur nga vendi i ndodhjes së vdekjes deri te vendi i varrimit, arkivolin me pajisje dhe kurorë, dhe vendin e varrimit;

- pllakën e varrit dhe përkujtimoren në lartësi më së shumti prej 12 rrogash mesatare të realizuara në Republikën e Maqedonisë në muajin e fundit para vdekjes, të verifikuara sipas të dhënave të publikuara nga Enti Shtetëror i Statistikës, përkatësisht në lartësinë e çmimit të përgjithshëm të pllakës së varrit dhe përkujtimores nëse kështu është përcaktuar nga ndërmarrja për shërbime të varrimit në vendin e varrimit dhe

- shpenzime të tjera me zakonet tradicionale fetare të familjeve gjatë kohës së varrimit në lartësi prej dhjet rrogash mesatare të realizuara në Republikën e Maqedonisë në muajin kur ka ndodhur vdekja.

Shpenzimet nga paragrafi 2 alinetë 1, 2 dhe 3 të këtij neni, bien në ngarkesë të organit shtetëror në të cilin ka qenë i punësuar pjesëmarrësi në operacione.

2. Kompensimi për sigurimin e detyrueshëm

Neni 19

Familjet e të rënëve, përkatësisht të pjesëmarrësve të vdekur kanë të drejtë të kompensimi për sigurim të detyrueshëm, i verifikuar në nenin 10 paragrafi 1 alineja 1 të këtij ligji.

3. Kompensimi i njëhershëm në para

Neni 20

Familjet e të rënëve, përkatësisht të pjesëmarrësve të vdekur kanë të drejtë të kompensimi të njëhershëm në para, për dhimbjet e shaktuara shpirtërore për shkak të vdekjes së personit të afërm, në lartësi prej 40 rrogave mesatare të realizuara në Republikën e Maqedonisë, në muajin kur ka ndodhur vdekja.

Kërkesa për realizimin e të drejtës nga paragrafi 1 i këtij neni, i dërgohet Ministrisë së Mbrojtjes, përkatësisht Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Mjetet për pagesën e kompensimit nga paragrafi 1 i këtij neni, sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

4. Punësimi i një anëtari të familjes

Neni 21

Qeveria e Republikës së Maqedonisë është e obliguar të sigurojë punësimin në organet shtetërore, ndërmarrjet publike dhe institucionet publike pa shpallje publike, të një anëtari të familjeve të të rënëve, përkatësisht pjesëmarrësve të vdekur, nëse i plotësojnë kushtet e përgjithshme ligjore dhe kushtet e parapara për punësim në vendin adekuat të punës.

Kërkesa për punësim, nga paragrafi 1 i këtij neni, i dorëzohet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë nëpërmjet organit shtetëror ku pjesëmarrësi ka qenë i punësuar, në afat prej një viti nga dita e vdekjes së pjesëmarrësve në operacionet.

5. Pensioni familjar

Neni 22

Çifti bashkëshortor, fëmijët dhe prindërit e të rënëve, përkatësisht të pjesëmarrësve të vdekur, kur nuk janë plotësuar kushtet e përgjithshme për fitimin e së drejtës së pensionit familjar, e fitojnë të drejtën e pensionit familjar sipas këtij ligji, nëse i plotësojnë kushtet e posaçme të verifikuara me dispozitat nga sigurimi pensional dhe invalidor.

Me përjashtim të paragrafit 1 të këtij neni, çifti bashkëshortor të drejtën e pensionit familjar e fiton pa marrë parasysh sa vjet ka, ndërsa prindërit pa marrë parasysh se a është mbajtur personi nga i rëni, përkatësisht pjesëmarrësi i vdekur.

Lartësia e pensionit familjar nga paragrafi 1 i këtij neni, përcaktohet në përqindje nga baza të cilën e përbën rroga e paguar e fundit të cilën i rëni, përkatësisht pjesëmarrësi i vdekur e ka realizuar në muajin para dërgimit në aktiviteteteve, edhe atë 100% për një ose më tepër anëtarë të familjes, por jo më tepër se lartësia e shumës më të lartë të pensionit në pajtim me Ligjin për sigurim pensional dhe invalidor.

Pensioni nga paragrafi 2 i këtij neni harmonizohet me përqindjen me të cilën harmonizohen pensionet e realizuara në pajtim me Ligjin për sigurim pensional dhe invalidor.

Neni 23

Çiftet bashkëshortore, fëmijët dhe prindërit e të rënëve, përkatësisht të pjesëmarrësve të vdekur, të cilët kanë realizuar të drejtën e pensionit sipas dispozitave për sigurimin pensional dhe invalidor, kanë të drejtë të pensionit familjar sipas këtij ligji, në rast se ai është më i volitshëm për ta.

Neni 24

Të drejtën e pensionit familjar në kuptim të këtij ligji, nuk mund ta realizojë, përkatësisht pushon ta shfrytëzojë bashkëshorti nëse lidh martesë të re.

Shfrytëzuesit të pensionit familjar nga nenet 22 dhe 23 të këtij ligji, derisa është në marrëdhënie pune ose kryen veprimtari të pavarur në Republikën e Maqedonisë ose jashtë vendit, i ndërpritet pagesa e pensionit.

Neni 25

E drejta e pensionit familjar nga nenet 22 dhe 23 të këtij ligji, realizohet në Fondin për Sigurim pensional dhe invalidor të Maqedonisë.

Mjetet për realizimin e së drejtës familjare sipas këtij ligji sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

6. Përkujdesja banesore

Neni 26

Anëtarët e familjes të cilët kanë jetuar në familje të përbashkët me të rënit, përkatësisht me pjesëmarrësit e vdekur dhe të cilët në territorin e Republikës së Maqedonisë nuk kanë në pronësi banesë ose shtëpi, dhe nuk shfrytëzojnë banesë me qira në pronësi të Republikës së Maqedonisë, kanë të drejtë për përkujdesje banesore.

Të drejtën nga paragrafi 1 i këtij neni, nuk mund ta shfrytëzojë çdo anëtar i familjes individualisht.

Neni 27

E drejta e përkujdesjes banesore të anëtarëve të familjes nga neni 26 të këtij ligji, realizohet me marrjen e banesës në pronësi me sipërfaqe banesore përkatëse, dhe atë:

- 40 m² për individ,
- 50 m² për familje dyanëtarëshe.
- 65 m² për familje treanëtarëshe.
- 75 m² për familje katëranëtarëshe,
- 90 m² për familje pesanëtarëshe, dhe
- 10 m² shtesë për çdo anëtar të ardhshëm të familjes mbi pesë anëtarë.

Kërkesa për marrjen e banesës në pronësi, i dërgohet Komisionit për zgjidhjen e çështjeve banesore pranë Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

Neni 28

Përparësi në realizimin e së drejtës së përkujdesjes banesore të anëtarëve të familjeve të pjesëmarrësve në operacionet, realizohet në pajtim me dispozitat për trashëgimi, në mënyrë që anëtarët e familjes nga radhët e trashëgimisë së njëjtë e realizojnë të drejtën në bazë të marrëveshjes së ndërsjellë me ç'rast këtë të drejtë mund ta shfrytëzojë vetëm një anëtar i familjes.

Banesën nga neni 27 i këtij ligji, e marrin në pronësi çifti bashkëshortor, përkatësisht fëmijët e të rënit, përkatësisht pjesëmarrësit të vdekur në operacionet ose tutori i tyre ligjor deri në moshën madhore të fëmijëve.

Fëmijët e të rënëve, përkatësisht të pjesëmarrësve të vdekur në operacione, nëse kanë jetuar në bashkësi me personin e rënë dhe nuk iu është zgjidhur çështja e banesës, e nuk kanë prindër të gjallë marrin banesë në pronësi.

Fëmijët e të rënit, përkatësisht të pjesëmarrësit të vdekur në operacione nga paragrafi 3 i këtij neni, kanë të drejtë të marrin vetëm një banesë.

Prindërit e të rënit, përkatësisht të pjesëmarrësit të vdekur në operacione me të cilët kanë jetuar i rëni, përkatësisht personi i vdekur, e të cilët nuk kanë banesë në pronësi, marrin banesë në pronësi nëse personi nuk ka bërë lidhur bashkësi bashkëshortore, përkatësisht nuk ka fëmijë.

Vendbanimin e përbashkët me të rënin, përkatësisht me personin e vdekur, prindërit e konfirmojnë me letërnjoftim.

Kërkesa për marrjen e banesës i parashtrohet Komisionit për zgjidhjen e çështjeve banesore pranë Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

Neni 29

Me përjashtim, nëse nuk ka mundësi për realizimin e së drejtës nga neni 28 paragrafi 5 i këtij ligji, prindërve të të rënit, përkatësisht të pjesëmarrësit të vdekur në operacione, të cilët në territorin e Republikës së Maqedonisë nuk kanë në pronësi banesë ose shtëpi, e as që shfrytëzojnë me qira banesë në pronësi të Republikës së Maqedonisë, mund t'iu jepet banesë nga banesat në pronësi të Republikës së Maqedonisë në shfrytëzim me qira, deri në vdekjen e tij pa të drejtë blerjeje.

Qiraja nga paragrafi 1 i këtij neni, është në ngarkesë të organit shtetëror në të cilin personi ka qenë i punësuar.

Neni 30

Mënyra e realizimit të së drejtave nga neni 26 deri në nenin 29 të këtij ligji, me akt e verifikon Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

7. Të drejtat nga lëmi i arsimit

Neni 31

Fëmijët e të rënëve, përkatësisht të pjesëmarrësve të vdekur kanë të drejtë të regjistrohen në shkollat e mesme publike, me zgjedhjen e tyre, me të drejtën e regjistrimit jashtë kuotës së përcaktuar me konkursin për regjistrimin e nxënësve në vitin e parë në shkollat e mesme publike, nëse i plotësojnë kushtet minimale të përcaktuara në konkurs.

Fëmijët e të rënëve, përkatësisht të pjesëmarrësve të vdekur kanë të drejtë të regjistrimit në institucionet e larta arsimore pa paguar participim për studime të rregullta të ciklit të parë të studimeve, jashtë kuotës së përcaktuar me konkursin për regjistrimin e studentëve në vitin e parë të studimeve me kusht që t'i plotësojnë kushtet minimale të përcaktuara me konkursin për regjistrim në institucionet e larta arsimore.

Neni 32

Fëmijët e të rënëve, përkatësisht të pjesëmarrësve të vdekur kanë të drejtë të bursës për shkollim të rregullt në shkollat e mesme publike dhe të drejtën e bursës për studime të rregullta në institucionet sipërore arsimore në Republikën e Maqedonisë, me kusht dhe mënyrë të konfirmuar nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

Mjetet nga paragrafi 1 i këtij neni i siguron Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Fëmijët e të rënëve, përkatësisht të pjesëmarrësve të vdekur, e humbin të drejtën e bursës për shkollim të rregullt në shkollat e mesme publike, nëse e humbin statusin e nxënësit të rregullt.

Fëmijët e të rënëve, përkatësisht të pjesëmarrësve të vdekur e humbin të drejtën e bursës për shkollim të rregullt në institucionet e larta arsimore publike, nëse nuk i plotësojnë kushtet e përcaktuara me rregullat për studime dhe statutin e institucionit të lartë arsimor.

Neni 33

Fëmijët e të rënëve, përkatësisht të pjesëmarrësve të vdekur kanë të drejtë të qëndrimit në konvikt të nxënësve, familje, përkatësisht konvikte studentore pa paguar participim.

Mjetet nga paragrafi 1 i këtij neni i siguron Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Fëmijët e të rënëve, përkatësisht të pjesëmarrësve të vdekur e humbin të drejtën e vendosjes në konvikt të studentëve, shtëpi, familje, nëse e humbin të drejtën e nxënësit të rregullt.

Fëmijët e të rënëve, përkatësisht të pjesëmarrësve të vdekur e humbin të drejtën e qëndrimit në konvikt të studentëve, në rast se nuk i plotësojnë kushtet e përcaktuara me rregullat për studime dhe statutin e institucionit të lartë arsimor.

8. Lehtësime doganore dhe tatimore

Neni 34

Anëtarët e moshës madhore të familjeve të të rënëve, përkatësisht të pjesëmarrësve të vdekur në operacionet, kanë të drejtë të blerjes së automjetit deri më 1 500 ccm³ në pronësi të tij për përdorim familjar.

Taksat doganore dhe tatimi mbi vlerën e shtuar për automjetin të cilat i paguajnë personat nga paragrafi 1 i këtij neni, i kompenson organi shtetëror në të cilin pjesëmarrësi në aktivitetet, përkatësisht operacione, ka qenë i punësuar.

Të drejtën nga paragrafi 1 i këtij neni mund ta realizojë në afat prej dy vjetësh nga çasti i vdekjes së pjesëmarrësit në operacione.

Të drejtën nga paragrafi 1 i këtij neni mund të realizojë vetëm një anëtar i familjes, vetëm një herë.

Nëse prindërit e pjesëmarrësve të rënë, përkatësisht të pjesëmarrësve të vdekur në operacione janë të divorcuar, të drejtën nga paragrafi 1 i këtij neni e ka prindi, i cili me të rënin, përkatësisht pjesëmarrësin e vdekur ka jetuar në familje të përbashkët.

Nëse shfrytëzuesi nga paragrafi 1 i këtij neni e shet ose e dhuron automjetin, para kalimit të shtatë vjetëve nga dita e blerjes, është i obliguar t'ia kthejë shumën e taksave doganore dhe tatimin mbi vlerën e shtuar për automjetin nga paragrafi 2 i këtij neni organit i cili i ka paguar të njëjtat.

Me përjashtim, nëse automjeti është shkatërruar dhe nuk është për përdorim, të njëjtin mund ta tjetërsojë, përkatësisht ta dhurojë pa obligim për kthimin e taksave doganore dhe tatimit mbi vlerën e shtuar edhe para kalimit të afatit nga paragrafi 6 i këtij neni.

Në rast të vdekjes së personit nga paragrafi 1 i këtij neni, para kalimit të shtatë vjetëve nga dita e blerjes së automjetit, trashëgimtarët ligjorë mund ta shesin automjetin të cilin e kanë trashëguar, pa paguar taksat doganore dhe tatimin mbi vlerën e shtuar.

9. Lirimi nga pagesa e taksave administrative dhe gjyqësore

Neni 35

Anëtarët e familjes së të rënëve, përkatësisht të pjesëmarrësve në operacione, në procedurat para organeve përkatëse për realizimin e të drejtave të garantuara me këtë ligj, lirohen nga pagesa e taksave administrative dhe gjyqësore.

10. Lirimi nga pjesëmarrja me mjete personale gjatë shfrytëzimit të shërbimeve shëndetësore

Neni 36

Familjet e të rënëve, përkatësisht të pjesëmarrësve në operacione, kanë të drejtë të lirimit të pjesëmarrjes me mjete personale gjatë shfrytëzimit të shërbimeve shëndetësore në mbrojtjen primare, specialistike-konsultative dhe mbrojtjen shëndetësore spitalore në institucionet shëndetësore në Republikën e Maqedonisë, në pajtim me ligjin të cilin e përcakton sigurimi shëndetësor.

Të drejtën nga paragrafi 1 i këtij neni prindërit e realizojnë përjetësisht, bashkëshorti deri në humbjen e statusit i ve/e vejë, ndërsa fëmijët deri në mbushjen e moshës 26 vjeçe.

Mjetet nga paragrafi 1 i këtij neni i siguron organi shtetëror në të cilin pjesëmarrësi në operacionet ka qenë i punësuar.

11. Vendosja në institucionet publike përkujdesje

Neni 37

Prindërit, përkatësisht çiftet bashkëshortore të të rënëve, përkatësisht të pjesëmarrësve në operacione, kanë të drejtë në përparësi gjatë vendosjes në institucionet për përkujdesje pa paguar participim.

Mjetet nga paragrafi 1 i këtij neni i siguron organi shtetëror në të cilin pjesëmarrësi në operacionet ka qenë i punësuar.

V. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 38

Dispozitat e këtij ligji u dedikohen edhe familjeve të pjesëmarrësve në operacionet, të rënë para ditës së hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 39

Aktin nënligjor nga neni 30 i këtij ligji Qeveria e Republikës së Maqedonisë, do ta miratojë në afat prej 90 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Нени 40

Ку лигј хуи нѐ фуџи дитѐн е тетѐ нга дита е бутимит нѐ “Газетѐн зуртаре тѐ Републикѐс сѐ Македонисѐ”.

1154.

Врз основа на член 75 ставови 1 и 2 од Уставот на Република Македонија, претседателот на Република Македонија и претседателот на Собранието на Република Македонија издаваат

У К А З
ЗА ПРОГЛАСУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА ИЗМЕНУ-
ВАЊЕ И ДОПОЛНУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА
МАТИЧНАТА ЕВИДЕНЦИЈА

Се прогласува Законот за изменување и дополнување на Законот за матичната евиденција, што Собранието на Република Македонија го донесе на седницата одржана на 21 мај 2009 година.

Бр. 07-2326/1
21 мај 2009 година
Скопје

Претседател
на Република Македонија,
Горге Иванов, с.р.

Претседател
на Собранието на Република
Македонија,
Трајко Вељаноски, с.р.

ЗАКОН
ЗА ИЗМЕНУВАЊЕ И ДОПОЛНУВАЊЕ НА
ЗАКОНОТ ЗА МАТИЧНАТА ЕВИДЕНЦИЈА

Член 1

Во Законот за матичната евиденција („Службен весник на Република Македонија“ бр.8/95, 38/2002, 66/2007 и 98/2008), членот 3-б се брише.

Член 2

По членот 30-а се додава нов член 30-б, кој гласи:

“Член 30-б

Содржината и начинот на водење на матичните книги во електронска форма од членот 3 на овој закон ги пропишува министерот за правда.”

Член 3

Во Законот за изменување и дополнување на Законот за матичната евиденција (“Службен весник на Република Македонија“ број 98/2008), во членот 12 став 1 зборовите: “членовите 4 и“ се заменуваат со зборот “членот“.

Член 4

Во Законот за изменување и дополнување на Законот за матичната евиденција (“Службен весник на Република Македонија“ број 98/2008), во членот 14 зборовите: “по 120 дена од денот на неговото влегување во сила“ се заменуваат со зборовите: “од 1 јануари 2010 година“.

Член 5

Подзаконскиот пропис од членот 2 на овој закон ќе се донесе во рок од шест месеца по неговото влегување во сила.

Член 6

Овој закон влегува во сила осмиот ден од денот на објавувањето во “Службен весник на Република Македонија“.

L I G J

ПËР НДРШИМИН ДНЕ ПЛОТËСИМИН Е
ЛИГИТ ПËР ЕВИДЕНЦËН Е АМЗËС

Нени 1

Нѐ Лигјин пѐр евиденцѐн е амзѐс (“Газета зуртаре е Републикѐс сѐ Македонисѐ” numѐр 8/95, 38/2002, 66/2007 dhe 98/2008), нени 3-б shlyhet.

Нени 2

Pas neni 30-a, shtohet neni i ri 30-b, si vijon:

“Нени 30-б

Pѐрmbajтjen dhe мѐнyрѐн е mbajтjes сѐ librave тѐ амзѐс нѐ formѐ електронике нга нени 3 тѐ кѐтјј лигји и pѐrcakton Ministri i Drejtѐsisѐ.”

Нени 3

Нѐ Лигјин пѐр ndryshimin dhe plotѐsimin e Лигјит пѐр евиденцѐн е амзѐс (“Газета зуртаре е Републикѐс сѐ Македонисѐ” numѐр 98/2008), нени 12 нѐ paragrafin 1 fjalѐт: “nenet 4 dhe“ zѐvendѐsohen me fjalѐн “neni”.

Нени 4

Нѐ Лигјин пѐр ndryshimin dhe plotѐsimin e Лигјит пѐр евиденцѐн е амзѐс (“Газета зуртаре е Републикѐс сѐ Македонисѐ” numѐр 98/2008), нени 14, fjalѐт: “pas 120 ditѐsh нга дита е hyrjes сѐ тјј нѐ фуџи“, zѐvendѐsohen me fjalѐт: “prej 1 janari 2010”.

Нени 5

Dispozita nѐnligјore нга нени 2 тѐ кѐтјј лигји do тѐ miratohet нѐ афат преј гјаштѐ муajsh пас hyrjes сѐ тјј нѐ фуџи.

Нени 6

Ку лигј хуи нѐ фуџи дитѐн е тетѐ нга дита е shpalljes нѐ “Газетѐн зуртаре нѐ Републикѐн е Македонисѐ”.

1155.

Врз основа на член 75 ставови 1 и 2 од Уставот на Република Македонија, претседателот на Република Македонија и претседателот на Собранието на Република Македонија издаваат

У К А З
ЗА ПРОГЛАСУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА ЗАСТАПУ-
ВАЊЕ НА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА ПРЕД
ЕВРОПСКИОТ СУД ЗА ЧОВЕКОВИ ПРАВА

Се прогласува Законот за застапување на Република Македонија пред Европскиот суд за човекови права, што Собранието на Република Македонија го донесе на седницата одржана на 21 мај 2009 година.

Бр. 07-2327/1
21 мај 2009 година
Скопје

Претседател
на Република Македонија,
Горге Иванов, с.р.

Претседател
на Собранието на Република
Македонија,
Трајко Вељаноски, с.р.